

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA	
	KOMUNA E MITROVICËS JUGORE OPSTINA.J MITROVICA/ MUNICIPALITY OF S.MITROVICA/	
	Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca	

NR.PROT	01-052/01-0004188/26
Datë	20.01.2026
PËR/ TO:	z. Faton PECI-Kryetari i Komunës
PËRMES/ CC:	
NGA/ FROM:	z. Bahtir MAXHUNI- Drejtor i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjenca
TEMA/ SUBJECT:	Raporti i Janar -Dhjetor 2025

Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca në muajin Janar 2025 aktivitetin e vet të programuar dhe të planifikuar nga lëmi i Mbrojtjes dhe Shpëtimit e ka realizuar duke u mbështetur në Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera **Nr. 04/L-027** , Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri **Nr. 04/L-012**, Ligjin për Zjarrfikëse dhe Shpëtim **Nr. 04/L-049**, Udhëzimet Administrative, Rregulloren e organizimit të brendshëm të Komunës, Vendimet e Bordit të Drejtorëve si dhe Aktet tjera normative të cilat e rregullojnë këtë materie.

I. Gjatë muajit **Janar** Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca ka hartuar dhe azhurnuar këto plane:

- Raportin e punës vjetore për Drejtorinë për Siguri dhe Emergjenca për vitin 2024;
- Hartimin e plan-programit të punës së Drejtorisë për Siguri dhe Emergjenca për vitin 2025.

❖ Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca përveç detyrave të lartë përmendura gjatë muajit Janar 2025 ka realizuar edhe këto detyra:

Kemi marr pjesë në konferencën e cila është organizuar në kuadër të projektit “Luftimi i ekstremizmit në Kosovë: prirjet, sfidat dhe kundër -masat” i mbështetur përmes programit Matra të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Kosovë.

Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca gjatë muajit **Janar 2025**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 4 kërkesa me shkrim nga qytetarët.

❖ Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca gjatë muajit **Shkurt 2025**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 3 kërkesa me shkrim nga qytetarët.

▪ Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca gjatë muajit **Mars 2025** ka realizuar këto detyra:

Kemi qenë pjesë e trajnimit me temën “**Procedura e Përgjithshme Administrative**” të organizuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP)

Kemi filluar me pastrimin e kanalit në lagjen Bair si masë preventive për të mbrojtur mjedisin dhe dëmtimin e pronave për rreth kanalit.

Kemi vazhduar pastrimin e një pjese të shtratit të lumit Trepça.

Është mbajtur mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi ku është diskutuar: Gjendja e sigurisë së Përgjithshme në Komunën e Mitrovicës, gjendja e sigurisë nëpër shkolla, rrezikshmëria nga qentë që bredhin lirshëm në territorin e Komunës së Mitrovicës dhe të ndryshme.

Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca gjatë muajit **Mars 2025**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 8 kërkesa me shkrim nga qytetarët .

Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca gjatë muajit **Prill 2025** ka realizuar këto detyra:

Kemi intervenuar në një pjesë të Lumit Trepça me qëllim të rregullimit të shtratit të lumit për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore eventuale si vërshimet.

Kemi intervenuar në pastrimin e kanalit në lagjen Bair afër tunelit të magjistrales së Adriatikut për heqjen e mbeturinave për rreth kanalit dhe pastrimin e shtratit me qëllim të rregullimit për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore.

Kemi kryer vendosjen e gypave të kanalizimit te Qendra Kryesore e mjekësisë familjare te objektit të rri te rruga kryesore “Agim Ramadani” Katana. Kemi intervenuar në hapjen dhe furnizimin me gypa të kanalizimit për funksionalizimin e objektit të ri të QKMF-së.

Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca gjatë muajit **Prill 2025**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 26 kërkesa me shkrim nga qytetarët .

▪ Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca gjatë muajit **Maj 2025** ka realizuar këto detyra:

Jemi takuar më përfaqësuesit e kompanisë Practal ku është diskutuar rreth vizitave të qytetarëve në parkun e erës dhe çështjeve që lidhen me sigurinë e tyre.

Kemi qenë pjesë e punëtorisë së organizuar nga Sektori i Medias, Departamenti i Demokratizimit dhe Njësia e Veçantë për Këshillim, Departamenti për Rend dhe Siguri Publike me temën Rritja e kapaciteteve të menaxhimit të mediave sociale të zyrtarëve komunal të komunikimit të Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave.

Kemi intervenuar në segmentin rrugor Stantërg-Rahovë për shkak të alterimit të dheut nga skapatet gjatë rrugës së fshatit ku kemi kryer pastrimin, largimin e materialit të alteruar nga kanalet mbrojtëse për gjatë segmentit rrugor.

Në kuadër të monitorimit të PLVBGJ kemi qenë pjesë e një **Panel Diskutimi me Ekspertë – Promovimi dhe Zbatimi i Barazisë Gjinore.**

Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia gjatë muajit **Maj 2025**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar **14** kërkesa me shkrim nga qytetarët.

Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia gjatë muajit **Qershor 2025** ka realizuar këto detyra:

- ❖ U mbajt takimi me Agjensioni për Informim dhe Privatësi lidhur me Informimin mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Është intervenuar në një pjesë të lumit Lushta me qëllim të pastrimit të shtratit të lumit, largimin e materialeve të forta të hedhura afër lumit për të parandaluar dhe mbrojtur nga fatkeqësitë natyrore eventuale.

Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia gjatë muajit **Qershor 2025**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar **9** kërkesa me shkrim nga qytetarët.

- Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia gjatë muajit **Korrik 2025** ka realizuar këto detyra:
Është mbajtur mbledhja Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi ku gjatë mbledhjes, u diskutuan një sërë çështjesh të rëndësishme për sigurinë publike, me theks të veçantë gjendjen e përgjithshme të sigurisë në Komunën e Mitrovicës, rrezikun nga zjarret dhe parandalimin e tyre, sigurinë në trafik, si dhe rrezikun e paraqitur nga qentë endacak në hapësirat publike.

Kemi mbajtur një takim me zyrtarët e Policisë në Bashkësi, zjarrfikësit, përfaqësuesit e KLSP ku është diskutuar për gjendjen në teren nga zjarret dhe për freskimin e qytetarëve në vendet që paraqesin rrezik etj.

Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia gjatë muajit **Korrik 2025**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar **18** kërkesa me shkrim nga qytetarët.

- ❖ Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia gjatë muajit **Gusht 2025** ka realizuar këto detyra:
U realizua zgjerimi dhe thellimi i pastrimit të një pjesë të Lumit Trepça, duke filluar nga fshati Rekë deri te pika e bashkimit me lumin Sitnica, për të parandaluar përmytjet dhe Fatkeqësitë Natyrore si vërshimet.
Pas shqyrtimit të kërkesave të paraqitura nga banorët, u ofrua ndihmë për furnizimin me materiale ndërtimi për rregullimin e mureve mbrojtëse dhe stabilizimin e infrastrukturës rrugore pas reshjeve të dendura.
Në fshatin Broboniq kemi intervenuar në pastrimin e përrojeve si masë preventive nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për të minimizuar rrezikun nga përmytjet, rrëshqitja e dheut dhe dëmtimet infrastrukturore.
Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia gjatë muajit **Gusht 2025**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar **19** kërkesa me shkrim nga qytetarët.

Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia gjatë muajit **Shtator 2025**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar **13** kërkesa me shkrim nga qytetarët.

Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia gjatë muajit **Tetor 2025**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar **9** kërkesa me shkrim nga qytetarët.

- Gjatë muajit **Nëntor** është intervenuar në sanimin e rrugëve dhe pastrimin e kanaleve për parandalimin e marrjes së ujit nga të reshurat e shiu në fshatrat Broboniq dhe Vaganicë e Epërme.
- Gjithashtu kemi intervenuar në vendosjen e gypave nga betoni dhe rrafshimin e rrugëve të cilat janë dëmtuar nga të reshurat e shiut në fshatrat Zabërxh, Maxher dhe Tërstenë.
- Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia gjatë muajit **Nëntor 2025**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar **5** kërkesa me shkrim nga qytetarët.
- Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia gjatë muajit **Dhjetor 2025**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar **3** kërkesë me shkrim nga qytetarët.